



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 26.1.2024

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 12.7.2023, parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 15.1.2024, si dhe parashtrimeve mbi *Gjetjen dhe Mendimin e përfaqësuesit ndërkombëtar*, të paraqitura në seancën e datës 19.1.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

1. Për shkakun ankimor mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 93,09 m², me adresë në rr. “* **”, Tiranë, për të cilën rezultuan rrethanat objektive si më poshtë:**

- (1) sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë të lidhur mes palëve, më datë **.12.2000, referohet *se çmimi është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale*, në vlerën 28.000 USD;
- (2) të dhënat bankare provojnë se një vlerë prej 8.000 USD është transferuar nga llogaria e subjektit në llogarinë e shoqërisë “*** **” sh.p.k., më datë **.2.2001;

edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegji, rezultoi se pretendimet e subjektit, se çmimi real i paguar për blerjen e apartamentit ka qenë në vlerën 28.000 USD dhe jo 36.000 USD, mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara. Në këto rrethana, në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar dhe në *Rekomandimin e ONM-së*, si dhe dokumentin *Gjetje dhe*

Mendim të përfaqësuesit ndërkombëtar, deklarimi i subjektit mbi çmimin real të blerjes është i pasaktë dhe i pamjaftueshëm, si dhe nuk mbështetet nga përmbajtja e akteve në dosje.

1.1 Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, në pyetësonin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. **, datë **.11.2022, bashkëlidhur këtij pyetësoni, lëshuar me kërkesë të subjektit nga shoqëria “**** **” sh.p.k., nënshkruar nga administratori, shtetasi **. **., për të cilin gjatë hetimit administrativ rezultoi se subjekti, në rrethana të diskutueshme, ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, ashtu sikurse është diskutuar gjatë debatit gjyqësor nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe Komisioneri Publik, nuk janë akte që kanë vlerë të plotë provuese, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.

1.2 Sjellim në vëmendje që vërtetimi i datës **.11.2022, lëshuar nga administratori i shoqërisë, z. **. **., në funksion të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, nuk përputhet as me përmbajtjen e vërtetimit të datës **.12.2022, lëshuar po nga kjo shoqëri, në përgjigje të kërkesës së Komisionit.

1.3 Ashtu sikurse parashtruar në dokumentin *Gjetje dhe Mendim të përfaqësuesit ndërkombëtar*, si dhe trajtuar gjatë debatit gjyqësor, standardi ligjor i pranuar dhe nga Kolegji, në vendimin e tij (JR) nr. 45/2022, dhe jo vetëm, për subjektin e rivlerësimit **. **., në paragrafin 75 të tij, referon vlerën e kufizuar provuese të deklaratave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit dhe faktit se vlera provuese e tyre vlerësohet nga trupi gjyqësor, rast pas rasti, *në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratave me provat e tjera të administruara në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj.*

1.4 Komisioneri Publik vlerëson se vlera provuese e vërtetimit të lëshuar nga administratori, shtetasi **. **., së bashku me rrethanat e dala nga debati gjyqësor, mbi pushimin e çështjes penale në ngarkim të këtij shtetasi¹, duhet të trajtohen në vlerësim tërësor të procedurave, si dhe në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklaratave të dhëna në to, së bashku me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision.

2. Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, kredi në formën e borxhit nga të afërm dhe miqtë, bazuar edhe në *Rekomandimin e ONM-së*, si dhe dokumentin *Gjetje dhe Mendim të përfaqësuesit ndërkombëtar*, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj, mbeti e provuar mospërputhja e deklaratave mbi shumat e huave nga huadhënësit në deklaratën e vitit 2003 dhe atë “Vetting”, si dhe mosdeklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, i ecurisë së marrëdhënies së huave dhe shlyerjeve të tyre.

2.1 Për sa më sipër, *Komisioneri Publik* vlerëson se: (1) deklaratimet kontradiktore lidhur me shumat e marra hua; (2) mosdeklarimet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të shlyerjes së tyre, si dhe (3) mungesa e provueshmërisë me dokumentacion provues lidhur me marrjen, kthimin dhe, (4) pamundësia financiare e huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, më së paku në një rast, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, janë rrethana, të cilat nuk kënaqin kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

¹ Referohuni pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar mbi procedurat e ndjekura mbi pushimin e çështjes lidhur me shtetasin **. **, si dhe qëndrimin të Komisionerit Publik, në seancën e datës 19.1.2024.

2.2 Bazuar në gjithë sa më sipër trajtuar, Komisioneri Publik, mbështetur dhe në *Rekomandimin e ONM-së, si dhe dokumentin Gjetje dhe Mendim të përfaqësuesit ndërkombëtar*, për rastin në fjalë, vlerëson se negativiteti i konstatuar, lidhur me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj, i pashtirë në vite, si dhe pasaktësitë dhe deklaratimet kontradiktore, janë të tilla që, parë në tërësinë e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni², për nga rëndësia e tyre, nuk lejojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit, mbështetur kjo dhe në praktikën e ndryshme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që tregojnë diferenca negative minimale, që kanë çuar në shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në zbatimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 (në vendimet e formës së prerë).

2.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ashtu sikurse dhe vëzhguesi ndërkombëtar është shprehur në dokumentin *Gjetje/Opinion* drejtuar Kolegjit, që përbën provë në këtë proces, zbatimi i parimit të proporcionalitetit, bazohet në faktet dhe veçoritë aktuale të çdo procesi rivlerësimi dhe në interpretimin e historikut financiar të secilit subjekt rivlerësimi dhe personave të lidhur me të (ose persona të tjerë), së bashku me elemente të tjera të vlerësimit të figurës dhe aftësive profesionale, në varësi të shqyrtimit të tyre.

3. Për shkakun ankimor mbi shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit, znj. *. ***, në Itali, për periudhën tetor 2013- prill 2014,** bazuar në *Rekomandimin e ONM-së, si dhe dokumentin Gjetje dhe Mendim të përfaqësuesit ndërkombëtar*, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte apo prova të reja që të provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit mbi faktin nëse në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit nuk kanë kaluar shuma të tjera, përtej bursës së shkollës, apo të provonte pamundësinë objektive për të siguruar një dokumentacion të tillë.

Kërkimi përfundimtar i ankimit

4. Në përfundim, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 12.7.2023, parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 15.1.2024, si dhe parashtrimeve mbi *Gjetjen dhe Mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar*, të paraqitura në seancën e datës 19.1.2024, që në zbatim të nenit B, pikës 3, germa “b”, të aneksit kushtetues dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, duhet konsideruar provë në këtë proces dhe vlerësuar si e tillë nga Kolegji;

5. Bazuar në sa më sipër referuar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe në një vlerësim tërësor të procedurave, ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

² Komisioni ka kryer edhe një analizë hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 36.000 USD, duke i rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme blerjen e këtij apartamenti në shumën - 1.274.340.34 lekë, pamjaftueshmëri për të cilën Komisioni ka arsyetuar se, edhe sikur për një moment të merret si vlerë e apartamentit shuma 36.000 USD, mungesa e mjeteve financiare është e tillë që, bazuar në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në raste të ngjashme, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

6. Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO